FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

SHTUESHMËRIA, RAISON D'ETRE PËR THEMELIMIN E FKGK-SË 2019

HYRJE

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është përgjegjës ndaj themeluesve dhe partnerëve, ndaj dhe analizat që tregojnë vlerësimin e ndikimit të FKGK-së në ekonomi në përgjithësi janë të domosdoshme.

Shtueshmëria është arsyeja thelbësore për themelimin e FKGK-së. Kjo do të thotë se bankat, Insititucionet Mikro Financiare ose Institucionet Financiare Jo Bankare nuk do t'i lëshonin një Ndërmarrje Mikro të Vogël dhe të Mesme (NMVM) kredi pa garancinë e dhënë, duke shtuar kështu një klient të ri dhe duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Qasja në kredi do të duhej të sillte punësim, rritje të prodhimit, të qarkullimit, të eksportit dhe të mira të tjera për ekonominë.

FKGK-ja për të vlerësuar efektin e shtueshmërisë edhe në vitin 2019 ka monitoruar indikatorët e shtueshmërisë.

Indikatorët e monitoruar ishin:

- Indikatorët e shtueshmërisë financiare, dhe
- Indikatorët e shtueshmërisë ekonomike.

SHTUESHMËRIA FINANCIARE

Shtueshmëria Financiare në relacion me skemën garantuese të FKGK-së pasqyron impaktin e skemës së garancisë në rritjen e çasjes në financa si dhe në përmirësimin e standardeve të kredidhënies për NMVM-të.

Për të vërejtur këtë impakt, FKGK ka analizuar indikatorët e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare duke reflektuar në të dhënat e siguruara nga Regjistri Kreditor i Kosovës (RKK) dhe të dhënat e siguruara nga MIS i brendshëm i FKGK-së. Me këtë rast u analizuan dhe u krahasuan kreditë e lejuara në sektor gjatë 2019 me kreditë e lejuara në sektor por të garantuara nga FKGK.

Rezultatet e monitorimit të këtyre indikatorëve na treguan se si në sajë të aktivitetit të FKGK-së nëpër gjithësi është rritur qasja në financa dhe janë relaksuar standarded e kredidhënies.

PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR

Ky tregues, edhe këtë vit, tregon një rritje të pjesëmarrjes së kredive të garantuara në sektorin bankar. Kjo rritje nënkupton ndikimin e FKGK-së në aktivitetin e kredidhënies në sektorin bankar e që për NMVM-të nënkupton qasje më të mirë në financa.

Në vitin 2019, kjo pjesëmarrje në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte 18%, ndërsa vetëm në kategorinë 25,000-50,000 euro ishte 22%.

Ky tregues shënoi rritje për 29% krahasuar me vitin 2018, kur pjesëmarrja ishte 14%. Një rritje e tillë tregon se skema e garancisë kreditore e FKGK-së e ka shtuar më tej ndikimin pozitiv në ndërmjetësimin financiar.

PJESËMARRJA E FKGK-SË NË SEKTOR (vlerë financiare)



Arsyeja e pasqyrimit në kategorinë deri në 100,000 euro është fakti se profili i klientëve në portofolin e FKGK-së i takon këtij segmenti në treg.

MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË - KOHËZGJATJE MË E LARTË E KREDIVE

Portofoli i garantuar gjatë vitit 2019 vazhdoi të përbëhej nga kreditë afatmesme me një mesatare prej 36 muajsh. Mesatarja e maturitetit të kredisë si tregues i shtueshmërisë financiare edhe këtë vit tregoi rritje të maturitetit të kredive të garantuara krahasuar me kreditë e pagarantuara. Rritja e maturitetit nënkupton kushte më të mira të financimit për kredimarrësit, ndërsa risk më të lartë për kredidhënësit.

Afati mesatar i kredive të garantuara deri në 100,000 euro ishte 38 muaj apo për 23% me i lartë se mesatarja e kredive të pagarantuara. Ky indikator, edhe gjatë vitit 2019, rezultoi në standarde më relaksuese të riskut nga ana e Institucioneve Financiare Partnere (IFP), prandaj edhe në kushte më të mira të kredimarrjes për NMVM-të, ndërsa për NMVM-të çdo rritje e maturitetit do ta rrisë kapacitetin e kredimarrësit për ta kompletuar investimin e planifikuar.



MBULUSHMËRIA ME KOLATERAL

Kolaterali është shumë shpesh njëra nga arsyet e refuzimit të kërkesës për kredi ose njëra nga arsyet e zvogëlimit të shumës së kredisë në kërkesë. Prandaj, në kuptim të ndikimit të skemës së garancive, kërkesa më e ulët për kolateral nënkupton para së gjithash përfshirje financiare me kushte më të mira të kredidhënies për klientët, kohë më të shkurtër për procedimin e kërkesave për kredi dhe kosto më të ulët të huamarrjes. Analiza e vitit 2019 rezultoi me një ndikim pozitiv të skemës së garancisë së FKGK-së, duke e zvogëluar kërkesën për kolateral për 66%.



Analiza e këtij indikatori ishte sfiduese duke qenë që regjistrimi i kolateralit ne sistemet bankare dhe në RKK nuk qëndron vetëm për një kredi por për gjithë ekspozimin kreditor. Ndaj dhe në këtë seksion nuk kemi sjell të dhënat rreth krahasueshmërisë së kolateralit të marrë në kategori të ndryshme për kredi të garantuara dhe të pagarantuara, por kemi treguar vetëm dallimin në kërkesën për kolateral. Gjetja e një modaliteti për matjen e këtij indikatori mbetet për tu diskutuar me gjithë partnerët në analizat e ardhshme.

SHUMA MESATARE E KREDISË

Ky tregues paraqet shumën mesatare të kredisë, për kreditë e garantuara kundrejt kredive të pagarantuara. Supozimet thonë se shuma mesatare më e lartë e kredisë, për kategoritë specifike, nënkupton standarde më të mira kredie nga ana e bankave, gjatë procesit të miratimit të kredisë.

Po ashtu, ky vit rezultoi me shumë mesatare më të lartë të kredive të garantuara për 30%, në krahasim me kreditë e pagarantuara në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro

Ngritja e shumës mesatare të kredisë përmes ndërmjetësimit të FKGK-së për këtë kategori e pasqyron ndikimin e skemës së garancisë në lehtësimin e standardeve të kredidhënies nga ana e bankave gjatë procesit të aprovimit të kredive të vendosura nën garanci.



KLIENTËT E RINJ/PËRFSHIRJA FINANCIARE

Pjesëmarrja më e lartë e kësaj kategorie të klientëve (të cilët nuk kanë marrë kredi asnjëherë) në portofolin e përgjithshëm të klientëve të kredisë nënkupton perceptim më të ulët të riskut nga bankat në raport me ndërmarrjet e sapokrijuara, pra nivel më të lartë të përfshirjes financiare për bizneset e reja.

Pjesëmarrja e kredive të garantuara për bizneset e reja pa përvojë të mëparshme në kredimarrje në vitin 2019 në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte për 41%, përderisa pjesëmarrja e kredive të pagarantuara e të njëjtit segment ishte 27%.

Ky përpjesëtim e pasqyron ndikimin e FKGK-së në përfshirjen financiare të sektorit privat pa përvojë të mëparshme në kredimarrje, prandaj edhe ndikimin pozitiv në sektorin financiar dhe në ekonomi në përgjithësi.



PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK në gjithsej bizneset taksapaguese është tregues tjetër i rëndësishëm i përfshirjes së NMVM-ve në skemën e garancive.

Bazuar në informatat që janë siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në vitin 2019 kishim përafërsisht 53,203 biznese aktive, ndërsa numri i NMVM-ve të cilat përfituan nga garancitë kreditore të FKGK-së deri në 2019 ishte 3,456, duke e sjellë pjesëmarrjen e NMVM-ve të garantuara në sektorin e NMVM-ve në 6.5% në fund të vitit 2019.

Kjo pjesëmarrje është duke u rritur nga viti në vit, duke e pasqyruar kështu rëndësinë e FKGK-së si dorë e zgjatur për zhvillimin e sektorit të NMVM-ve dhe ekonomisë në përgjithësi.

PJESËMARRJA E VËLLIMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK-JA NË BPV

Për ta kuptuar rëndësinë e instrumentit të garancive të FKGK-së në ekonominë kombëtare, ne e kemi llogaritur pjesëmarrjen e vëllimit të kredive aktive të garantuara nga FKGK-ja në Bruto Provuktin Vendor (BPV) deri në fund të vitit 2019. Në fund të vitit 2019, kjo pjesëmarrje ishte 0.62%, duke shënuar rritje prej 21% krahasuar me vitin 2018 (në fund të vitit 2018 ky përpjesëtim ishte 0.51%).

Krahasuar me shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore skemat garantuese të të cilave janë anëtare të Shoqatës Evropiane të Institucioneve Garantuese (AECM), Kosova, gjatë tri viteve të shkurtra të operimit, e ka arritur pothuaj mesataren e këtyre shteteve (0.71%, sipas AECM-së), i ka kaluar skemat garantuese të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe qëndron në pozitë relativisht më të mirë se shumica e skemave të garantimit të kredive, përkundër faktit se shumica e këtyre shteteve kanë përvojë të gjatë me skema garantuese, nëse krahasohen me Kosovën.

Një rritje e tillë e pjesëmarrjes së vëllimit të kredive të garantuara në totalin e volumit të kredive në këtë sektor (kreditë për NMVM-të) dhe në BPV-në e Kosovës është sinjal pozitiv drejt ngushtimit të hendekut të kreditimit në raport me BPV-në e vendit tonë.

SHTUESHMËRIA EKONOMIKE

Shtueshmëria Ekonomike - në relacion me skemën garantuese të FKGK-së na pasqyron impaktin e skemës së garancisë në përmirësimin e përformancës së NMVM-ve me investimin e bërë nga kredia e garantuar. Indikatorët e analizuar dhe të ndërlidhur me shtueshmërinë ekonomike ishin reflektim i të dhënave të siguruara nga IFP-të me rastin e vënies së kredisë nën garanci.

Rezultatet e monitorimit të këtyre indikatorëve ishin pozitive në aspektin e përformancës së NMVM-ve si dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Fushat e mëposhtme u analizuan për të vlerësuar ndikimin e skemës së garancive në ekonomi.

RRITJA E PARASHIKUAR E QARKULLIMIT VJETOR

Realizimi i investimeve krahas qasjes në financa duhet të rezultojë në rritje të qarkullimit të ndërmarrjeve përfituese.

Gjatë vitit 2019, kjo ka ndodhur edhe me ndërmarrjet që kanë qenë përfituese të garancive. Deri në fund të vitit 2019, janë aprovuar 1,790 kredi për NMVM-të me vëllim prej 69.1 milionë eurosh, prej nga, si rezultat i investimeve të realizuara, rritja e parashikuar e qarkullimit mbi qarkullimin bazë ishte 72.9 milionë euro, apo 11% mbi bazën aktuale.

RRITJA E QARKULLIMIT VJETOR (E PARASHIKUAR)



NUMRI I PARASHIKUAR I VENDEVE TË KRIJUARA TË PUNËS

Si rezultat i investimeve të realizuara nga kredia përmes mbështetjes së skemës së grancisë kreditore në rrethanat më të mira do të pasqyronte me vende të reja të punës të krijuara në sektorin privat.
Gjatë 2019 nga 1,790 kredi të miratuara janë parashikuar 2,803 vende të reja pune apo rritje prej 28% mbi bazën aktuale. Ndërsa, mesatarja e investimit për një vend të ri pune ishte 24,668.
Nga kjo tabelë mund të vërejmë se sa më e madhe kategoria e kredive aq më shumë kërkohe investim për të krijuar një vend pune. Kjo mund të arsyetohet me faktin që kompanitë e mëdha janë më të konsoliduara, kanë sisteme më efikase ndaj dhe kjo mund të rezultojë në krijim më të vogël të vendeve të punës.



KREDITË PËR GRATË NË BIZNES

Ky tregues fokusohet në përfshirjen e grave pronare të NMVM-ve në procesin e kredimarrjes.

Gratë ndërmarrëse marrin pjesë në kredimarrje formale në një shkallë më të ulët se burrat ndërmarrës. Për shkak të kësaj, FKGK-ja e ka caktuar si objektiv institucionale ofrimin e mundësive më të mira për sektorët ekonomikë dhe kategoritë e popullatës më pak të shërbyer, duke përfshirë gratë.

Gjatë vitit 2019, pjesëmarrja e kredive për gratë ndërmarrëse ishte 13%. Kjo pjesëmarrje shënoi rritje në krahasim me vitin paraprak. Rritja e pjesëmarrjes është mesazh se ndikimi i garancisë



PËRFUNDIM

Vlerësimi i shtueshmërisë financiare dhe ekonomike në vitin 2019, ka demonstruar ndikimin pozitiv në qasjen në financa, zbutjen e standardeve të kredidhënies si dhe në përformancën e brendshme të NMVM-ve përfituese duke bërë që institucionet partnere fiananciare të lëshonin kredi për NMVM-të që nuk do t'i kishin lëshuar përndryshe, duke shtuar një klient të ri në portofolin e tyre dhe duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendit.

Ky ndikim pozitiv mund të vërehet pothuajse në të gjithë indikatorët e analizuar si:

- Rritje të pjesëmarrjes së portfolios së garantuar në sektorin bankar;
- Rritje të pjesëmarrjes së NMVM-ve që kërkuan kredi për herë të parë;
- Mesatare më të lartë të kredive të garantuara;
- Mesatare më të lartë të maturitetit të kredive të garantuara;
- Kërkesë më të ulët për kolateral;
- Krijim të vende të reja të punës;
- Rritje të qarkullimin që potencialisht mund të ketë rritur eksportet dhe variablat e tjerë ekonomik;
- Rritje të pjesëmarrjes së kredidhënies ndaj grave pronare të bizneseve;
- Rritje të pjesëmarrjes në BPV.

Matja e shtueshmërisë është një sfidë e madhe ndaj dhe përpjekja për verifikim të rezultateve duhet të vazhdojë tutje.

Lidhur me këtë përqëndrimi ynë do të jetë në gjetjen e modaliteteve për vlerësimin e indikatorëve në terren për:

- Mbulueshmërinë me kolateral;
- Rritjen e vendeve të reja të punës;
- Rritjen a qarkullimit vjetor të NMVM-ve.

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Adresa:
Njazi Alishani nr. 5
10,000 Prishtina, Republic of Kosovo

Tel: +383 (0) 38 225 600

E-mail: info@fondikgk.org
www.fondikgk.org